

BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE – Deklarata e Mbrojtjes se te Dhenave –

Sondazhi i Investimeve të BEI-t (EIBIS)

1. Prezantimi

Banka Europiane e Investimeve (këtu e tutje “BEI”), është e përkushtuar për mbrojtjen e të dhënave personale. BEI mbledh dhe përpunon më tej të dhënat personale në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1725 të 23 Tetorit 2018, mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet dhe agjencitë e Unionit dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, dhe shfuqizimin e Rregullores (EC) nr. 45/2001 dhe Vendimit nr. 1247/2002/KE (këtu e tutje “EU DPR”).

Ky deklaram për mbrojtjen e të dhënave shpjegon arsyen për përpunimin dhe mënyrat e mbledhjes, trajtimit dhe sigurimit të mbrojtjes së të gjitha të dhënave personale. Për më tepër, ky deklaram shpjegon më tej mënyrat në të cilat informatat përdoren, dhe të drejtat e individëve të interesuar, që janë të disponueshme në lidhje me të dhënat e tyre personale.

Informacioni në lidhje me operacionin e përpunimit të Sondazhit të Investimeve të BEI-t (EIBIS) i ndërmarrë nga BEI është paraqitur më poshtë.

2. Kontrolluesi

Kontrolluesi i të dhënave është SG/ECON i Bankës Europiane të Investimeve (“BEI”).

3. Qëllimi i përpunimit

Ky deklaram për mbrojtjen e të dhënave siguron informacion në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të kryera nga BEI në kuadër të kryerjes së Sondazhit të Investimeve të BEI-t. BEI kryen këto detyra në ushtrimin e autoritetit që i është besuar në përputhje me Dispozitat e Traktateve dhe të Statutit të saj.

BEI përpunon të dhënat personale me qëllim të menaxhimit të Sondazhit të Investimeve të BEI-t, në një mënyrë të arsyeshme dhe të duhur, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Të dhënat personale përpunohen në përputhje me EU DPR.

Në kontekstin e Sondazhit të Investimeve të BEI-t, BEI përpunon të dhënat personale për qëllimin e kryerjes së Sondazhit të Investimeve të BEI-t, i cili mbledh të dhëna nga kompanitë në të gjithë BE-në, Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbi) dhe SHBA mbi aktivitetet e investimeve, kushtet e financimit dhe sfidat si: ndryshimet klimatike dhe transformimi dixhital. Sondazhi informon për diskutimet e politikave dhe mbështet krijimin e politikave në nivel kombëtar dhe të BE-së. Të dhënat personale gjithashtu përpunohen për komponentë të lidhur me sondazhin, duke përfshirë modulën e Zinxhirit të Furnizimit. Informacioni i disponueshëm publikisht për kompani mund të shtohet në të dhënat e sondazhit për qëllime analitike, duke siguruar që asnjë rezultat në nivelin e kompanisë së veçantë apo nivelin e entitetit publik të mos publikohet.

Sondazhi do të përdoret për të informuar dialogun e politikës mbi nxitësit dhe pengesat për investime dhe për të promovuar krijimin e politikave që mund të mbështesin më mirë bizneset dhe bashkitë në nivelin kombëtar dhe të BE-së.

Nëse subjektet e të dhënave janë përgjigjur në një valë të mëparshme të sondazhit, duke marrë pjesë në një valë tjetër të sondazhit, subjektet e të dhënave; japin pëlqimin që përgjigjet e tyre nga çdo valë të lidhen së bashku. Detajet personale të kontaktit nuk do të përfshihen.

Duke marrë pjesë në sondazh, subjektet e të dhënave japin pëlqimin që informacioni shtesë i disponueshëm publikisht në lidhje me kompaninë/organizatën/institucionin e tyre publike; të shtohet në të dhënat e sondazhit. Informacioni shtesë do të merret nga baza e të dhënave Moody's Orbis, Dun and Bradstreet, Bloomberg, agjencitë e vlerësimit, OECD, Marrëveshja e Kryetarëve të Bashkive të BE-së, Eurostat, Komisioni Evropian dhe baza e të dhënave statistikore të patentave në mbarë botën

PATSTAT, faqet e internetit publikisht të aksesueshme që përmbajnë informacion për kompani apo institucione publike, dhe ofrues të tjerë komercialë të informacionit të disponueshëm publikisht. Këto të dhëna do të përpunohen si të agreguara ose për qëllime analitike (si për shembull vlerësime apo analiza korrelacionale) dhe asnjë rezultat në nivelin e kompanisë/organizatës/institucionit publik nuk do të publikohet.

Përpunimi i të dhënave personale në kontekstin e Sondazhit të Investimeve të Grupit BEI nuk përfshin ekzistencën e vendimmarrjes automatike, përfshirë profilizimin.

4. Baza ligjore e përpunimit

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e Sondazhit të Investimeve të BEI-t është: pëlqimi i subjektit të të dhënave dhe interesi publik.

5. Kategoritë e subjekteve të të dhënave

Kategoritë e mëposhtme të subjekteve të të dhënave janë/mund të jenë të përfshira për sa i përket përpunimit në seksionin 3: klientët e BEI-t, personat e kontaktit të kompanive (jo-financiare) dhe institucioneve publike.

6. Çfarë të dhënash personale përpunon BEI?

BEI përpunon kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: emrin, detajet e kontaktit, titullin, profesionin.

Ofruesi ynë i shërbimit, Ipsos, përpunon kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: emri, detajet e kontaktit, titulli, pozicioni, inçizimet audio, adresa IP.

7. Ku i merr BEI të dhënat personale?

Të dhënat personale merren:

- direkt nga subjekti i të dhënave
- nga bazat e të dhënave që përmbajnë informacionin e kontaktit të kompanisë ose organit publik që përfaqëson subjekti i të dhënave.
- nga LinkedIn

8. Kujt i zbulohen të dhënat personale?

BEI mund t'i zbulojë të dhënat personale marrësve të mëposhtëm:

- Ipsos, ofruesi i shërbimeve të BEI, i cili mund të bashkëpunojë me agjencitë e hulumtimit të tregut dhe të punës në terren për të kryer sondazhin me telefon në mbarë botën.
- Në rast të pranimit për të marrë rezultatet e sondazhit, të dhënat personale mund të ndahen me agjencinë e komunikimit të BEI, e cila i përpunon të dhënat në emër të BEI nën kushte të rrepta konfidencialiteti dhe sigurie.
- Të gjithë partnerët e përdorur gjatë mbledhjes së të dhënave do të miratohen dhe përputhen me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave.

9. Transfertat Ndërkombëtare

Transferimet e të dhënave bëhen në Mbretërinë e Bashkuar, ku ndodhet ofruesi i shërbimit, nën kushtet e përcaktuara dhe të miratuara nga Komisioni Evropian. [standard contractual clauses for international transfers](#)

10. Sa kohë i mban BEI të dhënat personale?

Të dhënat personale mbahen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet e përshkruara në këtë deklaratë për mbrojtjen e të dhënave. Kriteret që përcaktojnë periudhën e ruajtjes janë si më poshtë:

- Kornizat e mostrës të marra nga bazat e të dhënave ose faqet e internetit të disponueshme publikisht siç specifikohet më sipër, mund të përdoren/azhurnohen si kornizë mostre për valët e ardhshme të sondazhit.
- Dosjet e dërguara te BEI dhe/ose agjencia e komunikimit të BEI nga ofruesi i shërbimeve për email-et e falënderimit do të përdoren vetëm për qëllimet e dërgimit të raportit të publikuar të sondazhit dhe ndahen vetëm brenda BEI ose me partnerin e komunikimit për përmbushjen e qëllimit.
- Periudha specifike e ruajtjes për ofruesin e shërbimeve, Ipsos, aplikohet: të dhënat personale të subjekteve, të mbledhura për qëllimet e valës aktuale të sondazhit do të hiqen në mënyrë të sigurt, jo më vonë se një vit pas kryerjes së saj, përveç nëse subjektet e të dhënave kanë dhënë pëlqimin që Ipsos ose një kompani tjetër kërkimore, t'i kontaktojë ata përsëri për qëllimet e një vale tjetër.

11. Cilat janë të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe si mund t'i ushtrojnë ato?

Të drejtat e subjekteve të të dhënave janë përcaktuar në seksionet 3 deri në 5 të Rregullores së Përgjithshme të BE për Mbrojtjen e të Dhënave.

- Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të marrin nga kontrolluesi, konfirmimin nëse të dhënat e tyre personale po përpunohen apo jo dhe, nëse po, të kenë akses në të dhënat e tyre personale duke kontaktuar kontrolluesin ose përmes DPQ të BEI (e drejta për akses);
- Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të kërkojnë nga kontrolluesi të korrigjojë çdo të dhënë të pasaktë dhe/ose të plotësojë të dhënat personale të paplota (e drejta për korrigjim);
- Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të kërkojnë nga kontrolluesi të fshijë të dhënat e tyre personale sipas Nenit 19 të Rregullores së Përgjithshme të BE për Mbrojtjen e të Dhënave (e drejta për t'u harruar);
- Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të kërkojnë nga kontrolluesi të kufizojë përpunimin e të dhënave të tyre personale në rastet e mëposhtme (e drejta për kufizimin e përpunimit):
 - (i) nëse ata kundërshtojnë saktësinë e të dhënave të tyre;
 - (ii) nëse përpunimi i të dhënave është i paligjshëm dhe ata kundërshtojnë fshirjen e tyre;
 - (iii) nëse kontrolluesi nuk ka më nevojë për të dhënat personale të referuara për qëllimet e përpunimit por subjekti i të dhënave përkatës i nevojitet për themelimin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore; ose
 - (iv) nëse subjektet e të dhënave kanë kundërshtuar përpunimin e të dhënave të tyre dhe BEI kërkon të përcaktojë nëse kontrolluesi ka baza legjitime që tejkalojnë të drejtën e subjekteve të të dhënave për kufizim.
- Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave personale, për arsye që lidhen me situatën e tyre të veçantë, përveç nëse BEI demonstroi arsye legjitime bindëse për përpunimin ose për krijimin, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore;
- Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të marrin të dhënat e tyre personale nga BEI në një format të strukturuar, të përdorur zakonisht dhe të lexueshëm nga makinat për t'i lejuar ata të transmetojnë të dhënat e tyre te një kontrollues tjetër pa pengesa nga BEI (e drejta për portabilitetin e të dhënave);
- Kur baza ligjore e përpunimit është pëlqimi, subjektet e të dhënave kanë të drejtë të tërheqin pëlqimin e tyre në çdo kohë. Tërheqja e pëlqimit nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit të bazuar në pëlqim para tërheqjes së tij;
- Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Mbikëqyrësit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave () në çdo kohë (e drejta për paraqitjen e ankesës). www.edps.europa.eu

12. Kontakti

Nëse subjektet e të dhënave kanë ndonjë pyetje në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale, ose dëshirojnë të ushtrojnë ndonjë prej të drejtave të sipërpërmendura, ju lutem na kontaktoni me email ose Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave të BEI-së, z. Pelopidas Donos, me email ose në adresën e mëposhtme: eibis@eib.orgp.donos@eib.org

Mr. Pelopidas Donos

European Investment Bank

98-100 Boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg (Grand Duchy of Luxembourg)